

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7037  
E enjte, 2 nëntor 2023  
Çmimi 0.50 €

Kurti: Një republikë  
e të gjithëve, jo vetëm  
e shumicës | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

NJËSITET SPECIALE TË POLICISË PROTISTUAN PARA NDËRTESESË SË QEVERISË SË KOSOVËS, KËRKUAN RRIJTEN E SHITESAVE PËR RREZIKSHMËRINË NË PUNË | FAQE 4-5

## 'KRYEMINISTËR, MOS LUANI ME DINJITETIN TONË!'



Pjesëtarë të Njësisë Speciale Intervuese të Policisë së Kosovës dhe të Njësisë për Trajtimin e Mjeteve Eksplozive protestuan të mërkurën para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar rishikimin e kategorizimit për rrezikshmërinë në punë. Javën e

kaluar qeveria njoftoi për shtesat për rrezikshmërinë në punë, të ndarë në shtatë kategori. Një përfaqësues i këtyre njësive elite policore tha se kërkesat e tyre janë: kategorizimi si njësi të veçanta dhe përfshirja në listën e ekspertëve, rrezikshmëria të

përcaktohet në 50 për qind të pagës bazë dhe të ketë shtesa për kushte specifike të punës. Ai shtoi se shprehon që përfaqësuesit e këtyre njësive të takohen shpejt me kryeministrin Kurti dhe që qeveria t'i marrë për bazë kërkesat e tyre

REAGIM NGA KMDLNJ-ja | FAQE 3

## DJE U BASTIS ARTAN BEHRAMI, SOT ISMAIL SYLA, CILI ËSHTË I RADHËS?!



### AKTUALE



SERBIA SHPALL ZGJEDHJET  
PARLAMENTARE DHE LOKALE PËR  
17 DHJETOR | F. 2

BASTISET NGA SPECIALJA, ISMAIL  
SYLËS I KONFISKOHEK TELEFONI | F. 6

HARADINAJ SHKON PËR  
NGUSHËLLIME TE FAMILJA VATA  
PAS NDARJES NGA JETA  
TË ATDHETARIT RIZAH VATA | F. 6

### EKONOMI



KOMUNA E PRISHTINËS CAKTON  
ORARIN E RI PËR FURNITORËT | F. 8

MINT KRYEN INSPEKTIME TEK  
OPERATORËT EKONOMIKË,  
VERIFIKON ÇMIMET E PRODUKTEVE  
DHE FLAMUJT E ORIGJINËS | F. 8

### SPORT



BALLKANI TREGON FORCËN EDHE  
NË DERBIN NDAJ DRITËS | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Serbia shpall zgjedhjet parlamentare dhe lokale, do të organizohen më 17 dhjetor

**BEOGRAD, 1 NËNTOR** - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, dhe kryetari i Parlamentit të Serbisë, Vladimir Orliq, njoftuan të mërkurën për shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare dhe zgjedhjeve lokale në disa qytete dhe komuna, përfshirë në kryeqytetin serb, Beograd. Zgjedhjet do të mbahen më 17 dhjetor 2023.

Me shpalljen e zgjedhjeve Vuçiqi ka shpërndarë Parlamentin serb që u zgjodh më 3 prill 2022. Paraprakisht, në Parlamentin serb kryeparlamentari Vladimir Orliq njoftoi se do të mbahen zgjedhjet për asamblatë lokale në 65 qytete dhe komuna.

Gjatë një paraqitjeje të shkurtër, Vuçiqi u uroi qytetarëve “zgjedhje të mbara”. Ai tha se “ne po jetojmë në kohë të vështira për gjithë botën, në kohën e ndryshimeve globale dhe në të cilën është e nevojshme që të gjithë të jenë të bashkuar për të luftuar ruajtjen e interesave kombëtare dhe shtetërore”. “Fushata është një mundësi për të shpalosur ide të ndryshme në mënyrë të civilizuar, për të prezantuar programe, politika që duhet të zbatohen, por të cilat kurrë nuk duhet t’i kërcënojnë interesat vitale shtetërore dhe kombëtare”, tha Vuçiq.

Ai u uroi të gjithëve “rezultate të mira në zgjedhje” dhe tha se



dëshiron që fushata zgjedhore dhe zgjedhjet të mbahen në mënyrë demokratike.

Kryeparlamentari Orliq u bëri thirrje qytetarëve të marrin pjesë në zgjedhje në mënyrë që, sipas

tij, Serbia si shoqëri ta tregojë “kapacitetin e saj të plotë demokratik”.

Më 30 tetor Qeveria e Serbisë i propozoi Vuçiqit të shpërndante parlamentin.

Në njoftimin e qeverisë serbe u tha se mbajtja e zgjedhjeve të reja parlamentare në rrethanat ekzistuese do të sigurojë, veç të tjerash, “një nivel të lartë të demokracisë dhe uljen e tensioneve midis mendimeve të ndryshme në shoqëri”.

Me shpalljen e zgjedhjeve, fushata parazgjedhore zyrtarisht ka nisur në Serbi. Fushata do të zgjasë deri mesnatën e 14 dhjetorit, kur do të nisë heshtja zgjedhore.

## A e pushtoi Izraeli Gazën? Ushtria nuk është e qartë

**JERUSALEM, 1 NËNTOR** - Gjatë gjashtë ditëve të fundit forcat tokësore izraelite kanë hyrë thellë në Gazë në luftën e tyre kundër Hamasit, që u shpall si përgjigje ndaj sulmeve të përgjakshme të 7 tetorit mbi Izraelin, të kryer nga grupi militant islamik.

Një grup në rritje njësisht, duke përfshirë forcat detare, ajrore dhe tokësore, i janë bashkuar përpjekjes. Ushtria izraelite tha se ka vrarë dhjetëra militantë dhe ka dëmtuar rrjetin strategjik të tuneleve të Hamasit. Ushtarët janë vendosur në shtëpitë e braktisura palestineze dhe kanë ngritur pozicionet e tyre.

Edhe pse operacioni po zgjerohet çdo ditë, ushtria izraelite refuzon ta quajë pushtim.

Përdorimi i fjalëve të paqarta për këtë temë është më shumë sesa një çështje semantike. Duket se është një strategji e qëllimshme që synon ta mbajë armikun jashtë balancës dhe t’i ruajë opsionet e tij teksa zhvillohet lufta e gjatë.

Në këtë tekst mund të mësoni më shumë se çfarë po bën Izraeli brenda Gazës.

### A është pushtim?

Në kuptimin e mirë të fjalës një pushtim izraelit duket se është duke ndodhur.

Trupat tokësore kanë lëvizur brenda territorit të armikut dhe po operojnë vazhdimisht atje që nga e premija e kaluar. Përderisa ushtria ka dhënë vetëm pak detaje specifike për operacionet e saj, ajo ka pranuar se tanket, artileria, këmbësoria, buldozerët dhe forcat speciale po marrin pjesë në të. Operacioni, sipas ushtrisë, po mbështetet nga sulmet ajrore. Ushtria ka qenë e paqartë lidhur me vendndodhjen apo madhësinë e trupave që ka



dërguar në Gazë. Por, në njoftimet e saj është sugjeruar se mijëra trupa u janë bashkuar përpjekjeve dhe numri i tyre duket se po rritet dita-ditës.

Palestinezët kanë përdorur gjuhë më të fortë, duke iu referuar bombardimeve izraelite me terma sikurse “masakër” dhe “gjenocid”. Ofensiva që po vazhdon deri më tani ka vrarë më shumë se 8 000 palestinezë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë që udhëhiqet nga Hamasit. Po ashtu, mijëra ndërtesa janë shkatërruar.

### Si e quan ushtria?

Ushtria refuzon që të thotë se e ka pushtuar Gazën, duke iu referuar aktiviteteve të saj si “bastisje” dhe “operacione”. Kjo bën që situata të

jetë fluide përderisa numri i trupave ndryshon dhe, tash për tash, Izraeli po shmang që ta sulmojë Hamasin me numër të madh ushtarësh dhe fuqi të madhe të zjarrit. Këto taktika duket se synojnë të nxisin konfuzion te Hamasit dhe të lënë të hapura mundësi të reja për aksione të mëtejme. Megjithatë, Izraeli e ka bërë të qartë se do të mbajë prani brenda Gazës gjatë periudhës së ardhshme.

Gjatë fundjavës, ministri i Mbrojtjes, Yoav Gallant, dhe kryeministri Benjamin Netanyahu, thanë se operacioni ka hyrë në një fazë të re. “Ne jemi në një fazë të re të luftës”, tha Gallant. “Toka në Gazë po dridhet. Operacioni do të vazhdojë deri në një urdhër të ri”.

Gjatë vizitës që ua bëri trupave të martën, Gallant shtoi: “Ne po dislokojmë forca në shkallë të madhe në thellësi të Gazës”.

### Cili është plani?

Izraeli i ka vendosur vetes dy qëllime: kthimin e të gjitha pengjeve dhe shkatërrimin e Hamasit, grupit militant të armatosur që ka mijëra luftëtarë, raketa, bomba, raketa kundërtanke dhe mbështetje të rëndësishme të publikut. Zëdhënësi i shefit të ushtrisë, admirali Daniel Hagari, vazhdimisht i referohet një plani metodik për t’i përbushur këto qëllime, edhe pse ai nuk e quan këtë pushtim. “Operacionet tona sulmuese do të vazhdojnë dhe do

të shtohen sipas planit”, tha ai të martën, më 31 tetor.

Amir Avivi, gjeneral në pension dhe ish-zëvendëskomandant i divizionit të ushtrisë për Gazën, tha se terminologjia e paqartë që përdor ushtria është e qëllimshme. “Ata nuk duan që armiku të dijë se çfarë po bëjnë”, tha ai.

Por, Avivi, i cili tani udhëheq Forumin për Mbrojtje dhe Siguri të Izraelit - një grup i përbërë nga ish-komandantët ushtarakë - tha se është e qartë se çfarë duhet të bëhet që të përbushen këto qëllime. “Ka vetëm një mënyrë që të bëhet kjo. Ata duhet ta pushtojnë të gjithë Rripin e Gazës dhe të kalojnë muaj e muaj të tërë duke çmontuar të gjitha aftësitë”, tha ai. “Çfarë ka lidhje se çfarë thotë ushtria”. (AP/Rel)

# Kurti: Një republikë e të gjithëve, jo vetëm e shumicës

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Kryeministri Albin Kurti ka thënë se duhet një republikë e të gjithëve, jo vetëm e shumicës. “E tillë është Kosova. E tillë është qeverisja jonë”, ka shkruar Kurti në “Facebook”. Ai ka thënë se në vitin 2022 si qeveri kanë mbështetur 123 projekte për biznese të vogla dhe start-ups nga radhët e të gjitha komuniteteve. “Këtë vit ndamë për herë të parë një fond të veçantë për komunitete joshumicë, në vlerë prej 3 milionë eurosh, me të cilat financuam 259 grante për fermerë, start-ups dhe OJQ me qëllim nxitjen e punësimit të këto komunitete. Me qëllim të njëjtë, themeluam Grupin Ndërinstitucional për Promovimin e Punësimit të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve”, ka thënë Kurti.

Ai ka theksuar se vitin e kaluar 104 qytetarë të këtyre tri komuniteteve përfituan nga trajnimet që ofrohen nga Qendra e Trajnimeve Profesionale - trefish më shumë se një vit më herët. “Ndërsa të dhënat e Agjencisë së Punësimit për vitin 2022 tregojnë se është shënuar një rritje prej 31 % të numrit të vendeve të punës që kjo agjenci ka gjetur për komunitetet



joshumicë, ndërkaq që numri i vendeve të punës për komunitete joshumicë përbën 12.5 % të totalit të vendeve të punës të gjetura përmes kësaj agjencie”, është shprehur Kurti. Më tej, ai ka thënë se komunitetet joshumicë përbëjnë 17 % të subvencioneve të Ministrisë së Ekonomisë për pajisje efçiente në kuadër të

masave për efçencë të energjisë. “9 % e praktikantëve me pagesë përmes programit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ‘Kosovo Generation Unlimited’ vijnë nga radhët e komuniteteve joshumicë, përqindje kjo përfaqësuese në raport me tërësinë e popullatës. Krahas buxhetit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për

ndërtimin e shtëpive të reja për 19 familje, pakove ushqimore dhe higjienike për 373 familje, orendi për 58 familje dhe materiale ndërtimore për 102 sosh, përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal kemi ndarë edhe 2 milionë euro për ndërtimin dhe rinovimin e shtëpive bashkë me 1 milion të tjera për projekte infrastrukturore prej të cilave

përfitojnë veçanërisht pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në komuna të vendit tonë”, ka deklaruar kryeministri.

Ai ka shtuar se ndër 15 vjet, bazuar në të dhënat vjetore të buxhetit 2008-2022, 10 komuna me shumicë serbe kanë pasur 62 % më shumë buxhet për kokë banori se 28 komuna të tjera të republikës. “Sivjet kanë qenë të planifikuara gjithsej 149 projekte kapitale në komuna me shumicë serbe që kapin vlerën e përgjithshme prej 12.3 milionë eurosh. Në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare, kemi rritur kapacitetet e Zyrës për Kontrollin dhe Harmonizimin Gjuhësor në gjuhët zyrtare. E përtej ligjit, së fundmi kemi filluar edhe transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve të qeverisë në gjuhën serbe, për informim më të mirë dhe më të drejtë të qytetarëve serbë me vendimet e qeverisë së tyre”, është shprehur Kurti.

Ai ka thënë se nga shkurti i këtij viti kanë rifilluar procesin e verifikimit të diplomave të Universitetit të Mitrovicës së Veriut duke ofruar kështu më shumë mundësi të reja të punësimit bartësve të këtyre diplomave.

## Mali i Zi liron dy të dyshuar për krime lufte në Kosovë

PODGORICË, 1 NËNTOR - Gjykata e Lartë në Bjello Pole ka liruar nga paraburgimi shtetasin serb Zhivko Vuksanoviq, 62 vjeç, ekstradimin e të cilit e ka kërkuar Kosova, pasi dyshohet për krime lufte. Po ashtu, edhe një tjetër i dyshuar, që po kërkohet nga Kosova, është liruar nga autoritetet në Mal të Zi.

Lirimi i Vuksanoviqit nga paraburgimi u konfirmua për “Radion Evropa e Lirë” nga kjo gjykatë.

Vuksanoviqi gjendej në paraburgim prej 1 tetorit, në pritje të vendimit për ekstradimin ose jo të tij në Kosovë.

Edhe pse Gjykata e Lartë më 27 tetor vendosi për ekstradimin e Vuksanoviqit në Kosovë, po atë ditë ish-ministri i Drejtësisë, Marko Kovaç, refuzoi kërkesën për ekstradim.

Gazeta në Podgoricë, “Pobjeda”, tha se Kovaç e arsyetoi vendimin e tij me vlerësimin se “ka dyshime për përndjekje politike”, duke argumentuar se ishte shkelur neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.

Pas marrjes së vendimit më 31 tetor, Gjykata e Lartë e liroi Vuksanoviqin, i cili qëndroi në paraburgim ekstradues për një muaj.

Ky ishte vendimi i dytë i tillë i ish-ministrit Kovaç në një periudhë shtatëditore, pasi më 26 tetor ai refuzoi edhe ekstradimin e Momçilo Vukotiqit, 61 vjeç, në Kosovë. Ekstradimi i tij ishte kërkuar për shkak se ai dyshohet për krime lufte në territorin e Pejës më 1999, konfirmuan për “REL”-in nga Ministria e Drejtësisë.

Dhe më pas, Kovaç iu referua Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kovaç i mori këto vendime në javën e fundit të mandatit të tij në qeverinë e kryeministrit Dritan Abazoviq, mandat që përfundoi me zgjedhjen e qeverisë së Millojko Spajiqit më 31 tetor 2023. Vukotiqi u arrestua në Mal të Zi më 25 shtator me urdhër të Interpol-it të lëshuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), bazuar në memorandumun e mirëkuptimit midis Interpol-it dhe UNMIK-it më 2002, që synon shkëmbimin e informacioneve, urdhër-arrestimeve, hetimeve ndërkombëtare dhe çështjeve penale.

Para arrestimit të tij, një nga liderët e Frontit Demokratik pro-serb të përbërë së fundi, Millan Knetheviq, i bëri thirrje qeverisë së atëhershme teknike të Abazoviqit që të mos përfshihet



në arrestimin e serbëve dhe malazezëve të zhvendosur nga Kosova.

Vukotiqi, po ashtu, është liruar nga paraburgimi, konfirmoi Gjykata e Lartë për REL-in.

Shtetasi i Kosovës, Ilir Bersha, 48 vjeç, i cili u arrestua në Mal të Zi në fillim të tetorit, është në pritje të vendimit për ekstradim në Kosovë dhe gjendet në paraburgim. Ai u arrestua me

urdhër të UNMIK-it dhe Interpol-it nën dyshime për krime lufte kundër popullatës civile në Kosovë në vitin 1999. Gjykata e Lartë në Podgoricë ka caktuar masë ndaj tij derisa të merret vendimi lidhur me çështjen e ekstradimit.

Që nga përfundimi i luftës në Kosovë rreth 70 persona janë dënuar për krime lufte para institucioneve vendore dhe

ndërkombëtare. Nga viti 2000 deri në vitin 2008, krimet e luftës në Kosovë u hetuan nga Misioni i Kombeve të Bashkuara, ndërsa nga viti 2008 Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit ishte përgjegjës për hetimet e krimeve të luftës.

Në vitin 2018 ky mision ka dorëzuar dokumente në Prokurorinë e Kosovës dhe në gjykatat vendore.



NJËSITET SPECIALE TË POLICISË PROTESTUAN PARA NDËRTHESËS SË QEVERISË SË KOSOVËS, KËRKUAN RRIJTJEN E SHITESAVE PËR RREZIKSHMËRINË NË PUNË

# “Kryeministër, mos luani me dinjitetin tonë!”

Pjesëtarë të Njësisë Speciale Intervenuese të Policisë së Kosovës dhe të Njësisë për Trajtimin e Mjeteve Eksplozive protestuan të mërkurën para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar rishikimin e kategorizimit për rrezikshmërinë në punë. Javën e kaluar qeveria njoftoi për shtesat për rrezikshmërinë në punë, të ndarë në shtatë kategori. Një përfaqësues i këtyre njësive elite policore tha se kërkesat e tyre janë: kategorizimi si njësi të veçanta dhe përfshirja në listën e ekspertëve, rrezikshmëria të përcaktohet në 50 për qind të pagës bazë dhe të ketë shtesa për kushte specifike të punës. Ai shtoi se shpreson që përfaqësuesit e këtyre njësive të takohen shpejt me kryeministrin Kurti dhe që qeveria t'i marrë për bazë kërkesat e tyre

dy njësi gjithmonë kanë dëshmuar profesionalizëm të lartë duke realizuar operacione, sidomos në pjesën më të ndjeshme të vendit, duke mbrojtur integritetin dhe sovranitetin shtetëror. Pakënaqësitë tona nuk datojnë nga dje, por ka më shumë se 10 vjet që kemi marrë premtime për benefite të cilat na takojnë, por

asnjëherë nuk janë realizuar. Fillimisht arsyet e mospërmbushjes së kërkesave tona ka qenë mungesa e Ligjit të Pagave”, ka thënë ai, duke shtuar se ka pasur edhe ulje në kategorizimin e rrezikshmërisë. “Madje shtesa e veçantë të cilën e kemi gëzuar nga viti 2010 u ndalua e tëra. Ne jemi unikë në kërkesat

tona sepse janë kërkesa legjitime dhe të nevojës urgjente. Nuk do të zbrapsemi deri në realizimin e tyre. Ftojme kryeministrin dhe qeverinë të ndërmarrin hapa konkretë për realizimin e tyre. Ju i nderuar kryeministër i dini shumë mirë rreziqet dhe kërcënimet që operatorët e këtyre njësive i bartin gjatë gjithë kohës, jo vetëm gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, por edhe në jetën private. Prandaj mos luani me dinjitetin tonë, me jetën e familjeve tona. Ne e kemi dëshmuar veten në shumë raste të kaluara, së fundmi në neutralizimin e grupit terrorist më 24 shtator. Kërkojmë që propozimin e dhënë për shtesat e rrezikshmërisë ta rishikoni dhe t'i pranoni kërkesat tona dhe presim që së shpejti të takohemi dhe t'i zgjidhim së bashku. Kërkesat tona janë: Kategorizimin si njësi të veçanta dhe përfshirja në listën e ekspertëve. Rrezikshmëria të caktohet në 50 për qind të pagës bazë dhe shtesa për kushte specifike të punës”, ka thënë një nga përfaqësuesit e këtyre dy njësive elitare të policisë. Më 27 tetor Qeveria e Kosovës paraqiti shtesat për rrezikshmërinë për pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Shtesat janë ndarë në shtatë kategori, varësisht prej pozitave të zyrtarëve policorë. Për njësitë elitare, përkatësisht për Njësinë Speciale Intervenuese, Njësinë për Ndërhyrje të Shpejtë

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 1 NËNTOR** - Njësia Speciale Intervenuese dhe Njësia për Trajtimin e Mjeteve Eksplozive kanë protestuar të mërkurën para Qeverisë së Kosovës për ta shprehur pakënaqësinë e tyre ndaj propozimit të Qeverisë së Kosovës për shtesat e rrezikshmërisë. “Njësia Speciale Intervenuese dhe Njësia për Trajtimin e Mjeteve Eksplozive sot jemi mbledhur para qeverisë për të protestuar dhe për t'i shprehur pakënaqësitë tona në lidhje me kategorizimin e rrezikshmërisë në punë, sidomos për shtesat e parapara me ligj. Këto dy njësi janë të trajnuara dhe të përgatitura me standardet më të

larta ndërkombëtare, janë të specializuar dhe certifikuar në luftën kundër terrorizmit, lirimit e pengjeve, si dhe rastet ku cenohet siguria kombëtare, gjithashtu edhe intervenime ku rrezikshmëria vlerësohet të jetë ekstreme. Prandaj jemi njësi elite të Policisë së Kosovës. Këto dy njësi janë të trajnuar nga akademitë dhe njësitë më prestigjioze në botë”, ka thënë një nga përfaqësuesit e këtyre dy njësive elitare të policisë para gazetarëve. Ai ka thënë se janë të përgatitur dhe të barabarta me njësi elite të botës e, sipas tij, një gjë të tillë e dëshmon pjesëmarrja dhe suksesi në shumë operacione policore e gara ndërkombëtare, duke sjellë edhe medalje për Kosovën. “Këto



# Serbia nuk i kërkon shtetasit e vet që arrestohen në Kosovë

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Mund të cilësohet edhe "strehë" për kriminelët e kërkuar nga Serbia. Katër shtetas serbë, me fletarrestim nga agjencia ndërkombëtare e policisë, Interpol, janë arrestuar këtë vit në Kosovë, i fundit më 30 tetor. Dy prej tyre tashmë janë liruar, pasi kanë kaluar periudhën prej 40 ditësh në paraburgim - aq sa e parasheh Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i Kosovës - dhe Kosova nuk ka marrë asnjë kërkesë nga Serbia për ekstradimin e tyre.

Dy vendet kanë Marrëveshje për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike qysh në vitin 2013, por zbatimi i saj lë për të dëshiruar. J. P., i kërkuar dhe i dënuar në Serbi për korrupsion, është kapur nga autoritetet e Kosovës muaj më parë në bazë të një fletarrestimi të Interpolit.

Ligji për bashkëpunim gjyqësor në çështjet penale thotë se në çdo rast kur Kosova arreston një shtetas të huaj në bazë të një fletarrestimi ndërkombëtar, atij i caktohet masa e paraburgimit prej 40 ditësh në pritje të kërkesës formale për ekstradim nga shteti që e ka lëshuar fletarrestimin ndërkombëtar.

J. P. nga Novi Sadi - identitetin e të cilit "Radio Evropa e Lirë" e ka të plotë - është liruar pas 40 ditësh, pasi shteti serb nuk ka shfaqur interesim për pranimin e tij, edhe pse është njoftuar nga Ministria e Drejtësisë e Kosovës për rastin e tij. "Pala serbe nuk do të bashkëpunojë as për personat që i ka shpallur vetë në kërkim", thotë për "Radion Evropa e Lirë" drejtori i Departamentit për



Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë në Kosovë, Gazmend Çitaku.

Në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), i cili monitorin punën e gjykatave në vend, thonë për "Radion Evropa e Lirë" se nëse shteti kërkuar - në këtë rast Serbia - nuk paraqet kërkesë zyrtare për ekstradim brenda 40 ditësh, "autoritetet gjyqësore në Kosovë nuk kanë rrugë tjetër veçse ta lirojnë të kërkuarin".

"REL"-i ka pyetur edhe Policinë e Serbisë, edhe Ministrinë e Drejtësisë atje se përse nuk i pranon personat e kërkuar që arrestohen në Kosovë, por prej asnjërit institucion nuk ka marrë përgjigje.

Sipas të dhënave që ka siguruar "REL"-i nga Policia e Kosovës, deri më tash këtë vit janë arrestuar katër shtetas të Serbisë me fletarrestim ndërkombëtar, ndërsa vitin e kaluar është arrestuar një.

Njohës të çështjeve gjyqësore thonë se epilogu i këtyre procedurave zakonisht ndikohet

nga vullneti politik i një vendi, i shprehur nëpërmjet institucioneve të tij.

"E kur jemi te vullneti politik, dihet se në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë ai mungon", thotë për "Radion Evropa e Lirë" Hamdi Ibrahim, ish-kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë. "Gjyqtari i procedurës paraprake, sipas detyrës zyrtare, e liron personin, nëse kërkesa për ekstradim nuk është pranuar nga gjykata brenda dyzet ditësh nga dita e arrestimit. Por, lirimi nuk e përjashton mundësinë e arrestimit të sërishëm dhe ekstradimin e tij apo të saj, nëse kërkesa për ekstradim pranohet më pas", shpjegon Ibrahim.

## Si vepron Kosova?

Meqë nuk është anëtare, Kosova në Interpol përfaqësohet nga Misioni i Kombeve të Bashkuara, UNMIK. Por, në pyetjet e "REL"-it në lidhje me të arrestuarit serbë në Kosovë, për të cilët Serbia nuk parashtrohet kërkesë ekstradimi,

UNMIK-u tha se që nga viti 2008, kur Kosova ka shpallur pavarësinë, ky mision nuk ka asnjë rol në këto çështje.

Me Marrëveshjen për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike është e paraparë që Kosova dhe Serbia të shkëmbejnë kërkesa gjyqësore përmes përfaqësuesve të Bashkimit Evropian.

Sipas marrëveshjes, Kosova e bën fillimisht kërkesën në Zyrën e BE-së në Kosovë, nga kalon te Zyra e BE-së në Serbi dhe prej aty te Ministria e Drejtësisë e Serbisë. Përgjigja, po ashtu, shkon në këtë formë.

Në Ministrinë e Drejtësisë në Kosovë thonë se përmes Zyrës së BE-së i kanë njoftuar autoritetet serbe për të katër shtetasit serbë të arrestuar këtë vit në Kosovë, por se nuk kanë marrë asnjë përgjigje.

Ngjashëm konfirmon edhe Zyra e BE-së në Prishtinë.

Që nga shtatori i vitit të kaluar, sipas saj, "nuk ka pasur as kërkesa, as përgjigje të shkëmbyera nga autoritetet serbe". "...në anën tjetër, autoritetet gjyqësore të Kosovës, në vazhdimësi dhe pa asnjë ndërprerje, i kanë përcjellë lëndët përmes përfaqësuesit special të BE-së tek autoritetet e Serbisë", tha Zyra e BE-së në një deklaratë me shkrim dërguar "REL"-it.

Nëse asgjë nuk ndryshon, gjasat janë që edhe serbi I. T., i arrestuar në Kosovë më 10 tetor në bazë të një fletarrestimi ndërkombëtar, të lirohet pasi ta përfundojë masën e paraburgimit prej 40 ditësh. Avokatja e tij, Fehmie Gashi Bytyqi, e caktuar nga Oda e Avokatëve e Kosovës, thotë për

REL-in se nga Interpoli ka vetëm fletarrestim për klientin e saj dhe jo dosje se për çfarë kërkohet.

Ajo thotë se ka kërkuar nga sistemi i drejtësisë në Kosovë që I. T. të mos ekstradohet në Serbi derisa të kryhen procedurat gjyqësore.

## A është zbatuar ndonjëherë Marrëveshja për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike?

Sipas IKD-së, Marrëveshja për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike me Serbinë është zbatuar kryesisht në raste civile.

Serbia nuk ka bashkëpunuar në asnjë rast që lidhet me krime lufte ose që përfshin individë të profilit të lartë, thotë IKD.

Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm të BE-së në Prishtinë i ka ofruar "REL"-it të dhëna nga viti 2020 deri në shtator të këtij viti, sipas të cilave, Kosova ka bërë 1 460 kërkesa në Serbi për lëndë të ndryshme gjyqësore, ndërsa përgjigje ka marrë në 415 prej tyre.

Serbia, gjatë periudhës së njëjtë kohore, i ka dorëzuar Kosovës 596 kërkesa, ndërsa përgjigje ka marrë për 1 050, pasi shumë prej tyre kanë përfshirë përgjigje në kërkesat e bëra para vitit 2020.

Aktualisht Kosova është duke bërë thirrje që Serbia t'i dorëzojë pjesëmarrësit në sulmin vdekjeprurës në Banjskë të Zveçanit, që besohet se gjenden atje.

Se si do të jetë epilogu i tyre, tash për tash është e paqartë.



dhe Njësinë për Mbrojtje të Afërt, shtesat do të jenë prej 150 eurosh mbi pagën bazë.

Ndërkaq, për Njësinë për

Eksplozivët dhe Deminim, qeveria tha se shtesa do të jetë në vlerë prej 120 eurosh.

Këto shtesa, sipas ekzekutivit, do të

aplikohen nga nëntori, pasi të hyjë në fuqi Ligji për Paga.

Pagat e policëve të Kosovës nisin nga 210 euro në muaj për kadetët

policorë dhe arrijnë në mbi 1 500 euro në muaj për drejtorin e përgjithshëm.

Policia e Kosovës është formuar 24 vjet më parë dhe ka mbi 9 000 pjesëtarë me grada të ndryshme. Ata nuk kanë as sigurim shëndetësor, as jetësor.

## Memli Krasniqi: Kjo fotografi është e vërteta e turpshme e kësaj qeverie të paaftë

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, duke e komentuar protestën e dy njësiteve elitare të policisë para Qeverisë së Kosovës, ka thënë se kjo është e vërteta e kësaj qeverie. "E vërteta e kësaj qeverie! Këtë fotografi nuk është dashur ta shohim kurrë! Posaçërisht, pas zhvillimeve të fundit në pjesën veriore të vendit tonë. Njësitë Special Intervenues dhe Njësitë për Trajtimin e Mjeteve Eksplozive, krenaria e shtetit tonë, detyrohen të protestojë para qeverisë së vendit të vet, kundër injorimit dhe nënçmimit që po ju bëhet nga ta. Përtej fjalëve boshe për Policinë e Kosovës, fatkeqësisht, kjo fotografi është e vërteta e turpshme e kësaj qeverie të paaftë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

## Abdixhiku: Heronjtë e veriut, djemtë më të zotë, të poshtëruar nga një qeveri që nuk dëgjon

Ndërkaq lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, këtë protestë e ka vlerësuar trishtim dhe dëshpërim. "Njësia më elitare e shtetit detyrohen në protestë. Heronjtë e veriut, djemtë më të zot, të poshtëruar nga një qeveri që nuk dëgjon për ta kur ata kanë nevojë. Kosova meriton më mirë. Kosova mundet më shumë", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

## Haradinaj, Kurtit: Kryeministër, çka po pret?


Për protestën e dy njësiteve elitare të policisë para Qeverisë së Kosovës ka reaguar edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ai e ka pyetur Kurtin se çfarë pro pret pas kësaj proteste. "Kryeministër, çka po pret? Policia ka të drejtë, respektojeni!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

## Bastisjet nga Specialja, Ismail Sylës i konfiskohet telefoni

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Ka përfunduar bastisja nga Dhomat e Specializuara në shtëpinë e Ismail Sylës, ish-këshilltar i ish-presidentit Hashim Thaçi, me ç'rast i është konfiskuar telefoni. Kështu ka bërë me dije avokati Artan Qerkini, i cili ka thënë se gjatë bastisjeve është konfiskuar vetëm telefoni i Ismail Sylës, derisa ka shtuar se po ta kishin ftuar këtë të fundit, do ta kishte dorëzuar telefonin pa pasur nevojë për bastisje.

Qerkini bastisjen e quan të kotë, duke potencuar se po cenohet privatësia e personave pa ndonjë bazë ligjore. "Është duke u cenuar privatësia e personave pa ndonjë bazë ligjore, pa ndonjë logjikë të shëndoshë

juridike. Kjo fushatë e bastisjeve tashmë është e njohur për opinionin publik dhe nuk ka asnjë njeri me inteligjencë mesatare, jo mbi mesatare, të mbante në shtëpinë e vet diçka inkriminuese duke e ditur se shumë lehtë mund të jetë shënjestër e bastisjeve. Prandaj, mendoj se të njëjtat janë të kota dhe nuk janë në funksion të realizimit të bastisjes, marrë parasysh rrethanat e rasteve konkrete. Asgjë s'është konfiskuar përveçse një telefon i cili i përket z. Sylës", tha Qerkini. Avokati Artan Qerkini ka thënë se ish-këshilltari Ismail Sylës dhe as të tjerët që janë bastisur gjatë kësaj jave, përkundër faktit që nuk e kanë statusin e personit të dyshuar, po bastisen.



## Iu konfiskuan dy iPad-at e fëmijëve gjatë bastisjes, Behrami i drejtohet me e-mail Speciales: Kur do t'ua ktheni?

Prishtinë, 1 nëntor - Zyra e Prokurorit të Specializuar tash e tri ditë është duke zhvilluar bastisje në Kosovë. Çak i këtyre bastisjeve këto ditë kanë qenë ish-këshilltarët e ish-presidentit Hashim Thaçi, Blerim Shala, Bashkim Smakaj, Artan Behrami dhe Ismail Sylës.

E ish-këshilltari i Thaçit, Artan Behrami, banesa e të cilit është

bastisur dje nga ZPS-ja, ka treguar se gjatë kësaj bastisje i janë konfiskuar edhe dy iPad-at e fëmijëve të tij.

Ai ka publikuar një e-mail të cilin ia ka drejtuar Gjykatës Speciale derisa i ka pyetur se kur do t'ua kthejë iPad-at fëmijëve të tij. "Të nderuar, dje gjatë një aksioni të paprecedent për bastisje në

banesën time, janë konfiskuar dy iPad-at e fëmijëve të mi, Teos (9) dhe Reit (7). Sot në mëngjes Teo dhe Rei i kërkuan iPad-at e tyre, sepse iu duheshin për praktikat ditore në shkollë. Përmes këtij e-maili ju pyes: kur do t'ua ktheni iPad-at fëmijëve të mi?", shkruan në e-mailin që Behrami i ka drejtuar Gjykatës Speciale.



## Stacioni i Policisë i Istogut pranon donacion nga KFOR-i

ISTOG, 1 NËNTOR - Në ambientet e Stacionit të Policisë në Istog, komandanti i tij, kapiten Enver Gashi, ka pranuar donacion për "dhomën mike" e cila do të përdoret nga hetuesit e dhunës në familje për intervistimin e viktimave të dhunës në familje dhe personave të mitur.

Ky donacion është dhuruar nga komandanti i brigadës Perëndimi, kolonel Gabriele Vacca. Të pranishëm aty ishin edhe kolonel Shaban Shala, drejtor i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë dhe kryetari i komunës së Istogut, Ilir Ferati.

Policia e Kosovës do të jetë

g gjithmonë falënderuese dhe mirënjohëse për ndihmën e ofruar si dhe bashkëpunimin e vazhduar në fusha të ndryshme dhe atë të sigurisë.

Ky donacion do të shërbejë për punë më efektive në "dhomën mike" në Stacionin e Policisë në Istog.

## Haradinaj shkon për ngushëllime te familja Vata pas ndarjes nga jeta të atdhetarit Rizah Vata

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, me kolegë nga kjo parti, kanë vizituar familjen Vata për t'i shprehur ngushëllime pas ndarjes nga jeta të veprimtarit të çështjes kombëtare, Rizah Vata. "Rizah Vata i takon brezit të të

burgosurve politikë të cilët u angazhuan për ndarje nga Jugosllavia, një atdhedashës i pashoq e luftëtar i dalluar i Ushtrisë Çlirimtare. Ngushëllimet më të sinqerta familjes Vata dhe miqve!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



REAGIM NGA KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

# Dje u bastis Artan Behrami, sot Ismail Syla, cili është i radhës?!

Gjykata Raciste Speciale e ka përvetësuar përsosmërisht mënyrën si ishte sjell UDB-a jugosllave dhe serbe ndaj shqiptarëve; marrja në biseda informative, bastisja dhe arrestime. Deri më tani nuk ka as të vrarë e as të plagosur nga kjo Gjykatë, e ardhmja nuk dihet. UDB-a jugosllave dhe serbe kishte informatorë - spiuj në radhët e shqiptarëve, të tillë i ka edhe GJRS-ja. UDB-a jugosllave dhe serbe arrestonte, dënonte dhe vraste atdhetarë shqiptarë që luftonin për të drejtat e tyre, kështu po vepron edhe GJRS-ja. Veprimtarët politikë përndiqeshin nga UDB jugosllave dhe serbe, të njëjtit po përndiqen edhe sot nga GJRS-ja. Artan Behrami, jo vetëm si ish-këshilltar i presidentit Thaçi por përkares i tij sot kur Thaçi po përballet me një gjyq qartësisht politik dhe etnik të motivuar, dje u bastis që nga mëngjesi i hershëm e deri në mbrëmje duke i marrë materiale, telefonë dhe pc sikur edhe duke i konfiskuar ajpedët e fëmijëve. Po të njëjtët hetues të GJRS-së, bastisën edhe banesën e prindërve të Artan Behramit duke shkakuar shqetësime dhe duke shkelur rëndë të drejtën e privatësisë. Pas bastisjes KMDLNJ u informua se Artan Behrami nuk ishte bastisur as si i dyshuar prandaj shtrohet një pyetje logjike; pse duhet të bastiset dikush aq brutalisht e aq gjatë dikush që nuk është as i dyshuar për veprë penale



sikur që ishte rasti me Artan Behramin dhe Bashkim Smakën. Për çdo shtet normal kjo do t'i aktivizonte dritat e alarmit në mbrojtje të të drejtave njerëzore të qytetarëve të saj nga abuzuesit ordinerë siç janë mercenarët e GJRS-së që kanë shërbyer, mbijetuar dhe përfituar në të gjitha vendet dhe shtetet, sidomos të ish-Jugosllavisë ku ka pasur luftëra të armatosura që nga Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Lugina e Preshevës. Sot që nga ora 7.15 minuta të mëngjesit KMDLNJ është

informuar se në Lagjen Emshir, hetues mercenarë të GJRS-së po bastisin shtëpinë e ish-këshilltarit të presidentit Thaçi, Ismail Syla, i keqtrajtuar brutalisht nga UDB-a jugosllave dhe serbe dhe i mbajtur në llogore - burgje të ish-Jugosllavisë mbi 8 vite. Po i njëjti, për veprimtari politike sot po terrorizohet, bashkë me familje nga GJRS-ja. Qartazi, GJRS-ja sipas një skeme të trashëguar nga UDB-a jugosllave dhe serbe po përpiqet ta thurr një rrjetë marimange nga ish veprimtarët politikë dhe kombëtar që kanë vuajtur burgje dhe kanë luftuar në radhët e UÇK-

së e që pastaj, pas çlirimit (çlirim i thënshin) kanë vazhduar të bashkëpunojnë me liderët ushtarakë dhe politikë që po gjykohen në Hagë, në përpjekje për t'i kriminalizuar, tash sipas një skeme të pengimit të administrimit të drejtësisë. UDB-a jugosllave dhe serbe e kishte një nen tjetër që e përdorte, propaganda armiqësore. Institucionet e Kosovës përkatësisht ato qeveritare as që reagojnë duke u arsyetuar se nuk duan të ndërhyjnë në drejtësi ndonëse nuk kanë lënë rast pa u deklaruar dhe pa e "pushkatuar" prokurorinë kur ka arrestuar

mbështetësit e qeverisë. Qeverisë së Kosovës duket se i konvenon kjo situatë për të zhvendosur vëmendjen nga shumë probleme me të cilat po përballet sikur edhe për faktin se me deklarime publike është thujta në të njëjtat valë me GJRS-në. Për KMDLNJ-n është e pabesueshme që deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk kërkojnë sqarime dhe llogaridhënie për mungesën e transparencës brutale të kësaj Gjykate aq më parë që llogariten të jenë themelues të kësaj Gjykate. KMDLNJ kërkon nga deputetët e kuvendit të Kosovës që ta bëjnë një komision hetimorë për të hetuar se kush ishte ai apo ajo, grup interesi apo parti që aq pamëshirshëm e poshtëroi sovranitetin e Kosovës duke ia bartur 100 përqind e sovranitetit juridik të Kosovës kësaj Gjykate monstër juridike. Kjo edhe është arsyeja dhe mbulesa që po e përdorë kjo Gjykatë për inkursionet e shumta të dhunës psikologjike ndaj qytetarëve të Kosovës.

KMDLNJ vlerëson se në mungesë të interesimit institucional, Gjykata Raciste Speciale në mënyrë flagrante po e shkel dhe keqpërdor nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e që bie nën përgjegjësi të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasbur në kohën kur "Avokati i Popullit i GJRS-së" në Hagë, i emëruar nga po kjo Gjykatë tredhë miza duke marrë një pagë marramendëse.

## Me koeficientin e ri, presidentes i rritet paga për 90 euro, kryeministrit dhe kryeparlamentarit nga 85 euro

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar të martën projektligjin për buxhetin e vitit 2024 në vlerë prej 3.3 miliardë eurosh. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në mbledhjen e qeverisë tha se për sektorin publik, koeficienti i pagave për vitin 2024 do të jetë 110 euro. E me rritjen e koeficientit tashmë siç është e rregulluar me ligj, rriten edhe pagat në sektorin publik. Rritjen më të madhe të pagave do ta kenë ata që kanë koeficient më të lartë, raporton Telegrafi. Në bazë të ligjit në Kosovë koeficientin më të madh e ka presidentja e Kosovës (18). Paga e presidentes me rritjen e koeficientit të pagave nga 1 890 euro sa e ka aktualisht, shkon në 1 980 (90 euro rritje). Paga e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese nga 1 837 euro, shkon në 1 925 euro (88 euro rritje). Paga e kryeministrit, kryetarit të

Kuvendit, kryetarit të Gjykatës Supreme, Kryeprokurorit të Shtetit rritet për 85 euro (nga 1 785 euro shkon në 1 870 euro). Paga e deputetëve dhe ministrave rritet për 82 euro (nga 1 722 euro shkon në 1 804 euro). Paga e kryetarit të Prishtinës dhe komandantit të FSK-së rritet për 75 euro (nga 1 575 euro shkon në 1 650 euro). Paga e ushtarit të FSK-së rritet për 28 euro (nga 588 euro shkon në 616 euro). Paga e gardianit të burgut rritet për 27.5 euro (nga 577.5 euro shkon në 605 euro). Paga e policit dhe zjarrfikësit rritet për 25 euro (nga 525 euro shkon në 550 euro). Paga e rektorit të UP-së rritet për 71 euro (nga 1 491 shkon në 1 562 euro). Paga e profesorit universitar rritet për 62 euro (nga 1 302 euro shkon në 1 364 euro). Paga e mësimitdhënës të shkollës



së mesme të lartë rritet për 29 euro (nga 609 euro shkon në 638 euro). Paga e mësimitdhënës të shkollës së mesme të ulët rritet për 28 euro (nga 588 euro shkon në 616 euro).

Paga e edukatorit rritet për 26 euro (nga 546 euro shkon në 572 euro). Paga e mjekut specialist rritet për 60 euro (nga 1 260 euro shkon në 1 320 euro).

Paga e infermierit rritet prej 25 deri 30 euro. Koeficientet e të gjitha kategorive të sektorit publik mund t'i shihni në Gazetën Zyrtare.

## Komuna e Prishtinës cakton orarin e ri për furnitorët

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Pas takimeve intensive të zhvilluara në mes të Grupit të Biznesit dhe komunës së Prishtinës, në të cilin takim ka qenë nënkryetari Arsim Selmonmusaj përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, palët janë marrë vesh për vendosjen e një orari të ri të lëvizjes për furnitorët rreth qarkullimit të mjeteve motorike për furnizim me mallra nga

subjektet afariste. Orari i ri i qarkullimit për furnitorët i cili do të fillojë të aplikohet pas njoftimit zyrtar që pritet të publikohet nga komuna e Prishtinës është: Lejohet qarkullimi i mjeteve motorike nga ora 10:00 deri në orën 15:00; Lejohet qarkullimi i mjeteve motorike nga ora 18:00 deri në orën 07:00; ndërsa deri në atë kohë nuk do të ketë ndalesa për furnitorët.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë që nga fillimi i aplikimit të vendimit të komunës së Prishtinës për kufizimin e qarkullimit të mjeteve motorike për furnizim me mallra nga subjektet afariste ka reaguar se ky vendim fillimisht të pezullohet deri në arritjen e një marrëveshje e cila është e përshtatshme për të dyja palët, e cila tashmë ka ndodhur.



# BQK-ja ka në fokus edukimin financiar, qasjen në financa dhe promovimin e gjithëpërfshirjes financiare

**EPOKA E RE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Banka Qendrore e Kosovës nëpërmjet edukimit financiar do të kontribuojë në vetëdijesimin e qytetarëve për rëndësinë e përgjegjësisë financiare për kursime në të ardhmen. Kështu është shprehur guvernatori Ahmet Ismaili para ligjëratis së mbajtur para nxënësve të Gjimnazit "Xhevdet Doda" në hapësirat e BQK-së në Ditën Botërore të Kursimeve, duke shtuar se BQK-ja do ta ketë në fokus edukimin dhe promovimin e qasjes dhe gjithëpërfshirjes në financa. "BQK-ja do ta ketë në fokus edukimin financiar, qasjen në financa dhe promovimin e gjithëpërfshirjes financiare, në bashkëpunim me institucionet relevante. Bota po ndryshon shpejt e ne duhet të jemi në hap me të, ndryshimet e avancuara të teknologjisë informative dhe transformimit digjital, ndryshimet mjedisore e sociale, të cilat janë bërë pjesë e përditshmërisë tonë, e ne duhet të përgatitemi të përballemi me to", ka theksuar guvernatori Ismaili.

Sipas guvernatorit Ismaili, këto aktivitete nga BQK-ja po mbahen me qëllim të vetëdijesimit dhe nxitjes së të rinjve për t'u informuar e kuptuar aftësinë e menaxhimit të duhur të financave. "Sot me shumë se kurrë është e rëndësishme dhe e nevojshme që të kultivojmë një kulturë të mirëfilltë të menaxhimit e mbrojtjes së financave personale dhe mbrojtjes së ambientit në mënyrë që në aspektin social e



mjedisor si individë, si familje apo si shoqëri të kemi stabilitet e qëndrueshmëri", shtoi guvernatori i BQK-së. Guvernatori Ismaili, po ashtu, ka potencuar se të rinjtë duhet të krijojnë njohuri dhe shprehni për kursime. Në këtë prezantim guvernatori Ismaili ka zyrtarizuar shpalljen e konkursit për dhjetë

esetë më të mira për nxënësit e klasave X-XII të shkollave të arsimit të mesëm të lartë të Republikës së Kosovës. "Duke pasur parasysh nxitjen e të rinjve që të mësojnë e informohen sa më shumë rreth rëndësisë së kursimeve, sot shpall konkurs për nxënësit e klasave X-XII të shkollave të arsimit të mesëm të

lartë të Republikës së Kosovës, të realizojnë punime apo ese mbi konceptin e tyre për kursimet. Konkursi do të jetë i hapur një muaj dhe pas mbylljes komisioni përzgjedhës do t'i vlerësojë dhe do t'i përzgjedhë 10 nga punimet më të mira, të cilat do të shpërblehen edhe financiarisht", është shprehur i pari i BQK-së.

## MINT kryen inspektime tek operatorët ekonomikë, verifikon çmimet e produkteve dhe flamujt e origjinës

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka njoftuar se Inspektorati i Tregut ka kryer inspektime lidhur me ligjshmërinë e tregtimit të produkteve, verifikimin e përputhjes së çmimeve raft - arkë dhe vendosjes së flamujve të origjinës nëpër operatorët ekonomikë në Kosovë. "Gjatë

inspektimit në disa raste u konstatuan parregullsi, me ç'rast do të procedohet sipas ligjeve në fuqi. Me këtë rast ftojme qytetarët-konsumatorë që të jenë të vëmendshëm gjatë blerjeve dhe për çdo shkelje të të drejtave të konsumatorit, të vazhdojnë të adresojnë ankesat/njoftimet në Inspektoratin e Tregut, përmes

Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit në Ministri të Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë", ka njoftuar MINT. Inspektorati i Tregut ka njoftuar se në vazhdimësi kryen verifikime dhe inspektime në terren me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit dhe do të vazhdojë ta bëjë të njëjtën gjë edhe gjatë ditëve në vazhdim.





# 'Pushtimi i jashtëtokësorëve' që mashtroi ShBA-në



**Orson Welles gjatë një konference për shtyp, më 31 tetor 1938, ku gazetarëve u tha se nuk ka besuar se shfaqja "Lufta e botëve" do të shkaktojë panik kombëtar**

Nga: **Myles BURKE** / BBC  
Përkthëu: Agron SHALA /  
Telegrafi.com

Ekziston një incident që me të madhe ka ndikuar në kulturën popullore: aq realist ka qenë transmetimi i dramës radiofonike të Orson Wellesit, për një pushtim marsian të Tokës – transmetim ky që ndodhi 85 vjet më parë [30 tetor 1938] – saqë thuhet se shkaktoi një panik masiv në ShBA. Në të vërtetë, historia e histerisë masive është aq shumë e rrënjësorë në folklorin mediatik saqë, në fakt, për dekada të tëra kurrë nuk u sfidua.

Por, në vitet e fundit, historianët – si profesori W Joseph Campbell i Universitetit Amerikan në Uashington DC – kanë argumentuar se paniku i supozuar gjatë gjithë kohës ka qenë i ekzagjeruar dhe se shumica e dëgjuesve e kanë kuptuar se programi ishte një vepër letrare. Ideja e kombit të zhytur në histeri, në mënyrë aktive u nxit nga gazetaret e asaj kohe të cilat ishin të prira që radion ta karakterizonin – në atë kohë një medium në zhvillim dhe konkurrent i gazetave – si të papërgjegjshme dhe si diçka që nuk duhet besuar. Dhe, vetë Orson Welles i lustroi mitin përmes ritregimeve të panumërta nëpër emisionet e debateve në vitet që pasuan.

Por, gjersa është e paqartë se deri në çfarë mase u shkaktoi paniku, disa fakte mbesin – kryesisht ato se transmetimi e dëshmoi fuqinë dhe potencialin e hershëm të radios. Në mbremjen e 30 tetorit 1938, pak para Hallouinit, Welles – në atë kohë regjisor dhe ylli i serisë së dramës radiofonike Teatri Merkur në transmetim të drejtpërdrejt [Mercury Theatre on the Air] – po

bëntë provat e minutës së fundit për transmetimin e tij të ri inovativ. Welles ishte vetëm 23 vjeç në atë kohë dhe nga shumë njerëz vlerësohej si gjeni – ky ishte projekti i tij më ambicioz, deri atëherë, një si përditësim i Luftës së botëve [The War of the Worlds], i trilerit të fantashkencës së HG Wellsit të botuar në vitin 1898.

Plani i tij ishte ta gjallëronte historinë e Wellsit, duke e vendosur në kohën moderne, duke e krijuar një ndjenjë të urgjencës dhe të frikës. Vendndodhjen e ndryshoi nga Anglia në Nju-Xhersi dhe e rishkroi rrëfimin si një seri të buletineve reale të lajmeve që raportonin për një pushtim të pandalshëm të jashtëtokësorëve nga Marsi, diçka që dukej si në kohë reale, dhe duke i mjegulluar kështu linjat midis realitetit dhe trillimit. "E bëmë këtë me shumë kujdes dhe saktësisht e riprodhuam atë që do të kishte ndodhur. Kemi menduar se kështu do ta bëjmë më efektive. Por, nuk e kishim idenë se sa efektive do të ishte", tha ai në një episod të vitit 1955, të një serie të BBC-së të quajtur Fletorja e Orson Wellesit [Orson Welles's Sketch Book].

Rrethanat e ofruan sfondin e përsosur për këtë realizim. Në atë kohë, radioja me shpejtësi i zëvendësonte gazetaret si një hapësirë ku shumica e amerikanëve mësonin për ngjarjet e përditshme. Gjithashtu, ishte një ndjenjë e përgjithshme ankthi për një tjetër konflikt në Evropë dhe, teksa u përshpejtuan ngjarjet që botën po e çonin drejt Luftës së Dytë Botërore, audiencia amerikane gjithnjë e më shumë po familjarizohej me lajmet kryesore që ndërprisnin programet e planifikuara radiofonike.

Në orën 20:00 sipas kohës lindore,

transmetimi filloi me vetë Wellesin duke e prezantuar dramën dhe duke sqaruar se ishte një vepër letrare. Por, dëgjuesit që e dëgjuan më vonë, e humbën sqarimin që dha, ndërsa disa që e dëgjuan nuk e morën parasysh – ose thjesht e haruan gjatë kohës që drama po zhvillohej.

Ajo që pasoi ishte një program i rregullt muzikor, i njohur për dëgjuesit, që ndërpritej nga një seri e buletineve të lajmeve, të simuluar në mënyrën gjithnjë e më të furishme. Aktorët që portretizonin reporterët dhe zyrtarët qeveritarë, pa frymë përshkruanin ardhjen e pushtuesve jashtëtokësor dhe këto përshkrime u kombinuan me efektet rrëqethëse realiste të rrezeve të nxehtësisë vdekjeprurëse të jashtëtokësorëve – si dhe me shkatërrimin e qyteteve të tëra.

Efekti ishte bindës dhe i tmerroi dëgjuesit. Stili dokumentar i dramës dhe dialogu natyralist, bënë që disa ta ngatërrojnë me një transmetim të vërtetë të lajmeve. Gazetarët më vonë raportuan se dëgjuesit e shqetësuar, duke besuar se fundi i botës ishte i afërt, u përpoqën të largoheshin nga shtëpitë e veta, ndërsa të tjerët mblodhën armët dhe u përgatitën për t'u mbrojtur kundër jashtëtokësorëve.

Linjat telefonike u bllokuan, meqë dëgjuesit e alarmuar përqeshin të thërrisnin policinë dhe gazetaret për të marrë informacione ose për të kërkuar siguri. Ky fluks i telefonatave mund të ketë bindur shumë gazetarë se emisioni shkaktoi panik mbarëkombëtar. Së shpejti, policia u shfaq në studion e CBS-it ku po jepej drama dhe atëherë ka krisur një përlëshje mes policëve dhe drejtuesve të radios të cilët me çdo kusht

përpiqeshin t'i pengonin që të futeshin brenda dhe ta ndalonin shfaqjen.

Wellesi, i cili ishte në mes të shfaqjes, e kuptoi efektin që kishte shkakuar "sepse kah gjysma e shfaqjes, teksa vazhdonim me skenarin që kishim përpara, pamë se në dhomën e kontrollit ishin shumë policë dhe se në çdo moment vinin më shumë nga ta. Nuk e kisha idenë se papritmas u shndërrova në një lloj të lajmit kombëtar".

Menjëherë pasi emisioni u ndalua, Walter Winchelli – i cili ishte në një rrjet rival dhe kishte dëgjuar se si ishin bllokuar të gjitha linjat telefonike – shkoi në programin e tij të komenteve të lajmeve dhe tha: "Z. dhe znj. Amerikë, nuk ka asnjë shkak për alarm. Amerika nuk ka rënë. E përsëris, Amerika nuk ka rënë".

Menjëherë pas kësaj, Welles dhe ekipi i tij u përballën me një reagim të fortë nga mediat dhe nga qeveria. Transmetimi dominoi titujt e gazetave të së nesërme, me shumë gazetarë që raportonin sipas anekdotave, për të bërë pretendime gjithëpërfshirëse për amerikanët e pushtuar nga paniku. Kjo ndihmoi në forcimin e përshtypjes se shfaqja e Wellesit kishte krijuar histeri.

Kishte kërcënime për padi dhe thirrje për censurë dhe për rregullim të përmbajtjes së radios. CBS-i me nxitim mbajti një konferencë për shtyp, ku Wellesi vazhdimisht mohoi se qëllimi i tij ishte të mashtrohej ndokënd. Në fund të fundit, Komisioni Federal i Komunikimeve hetoi incidentin dhe zbuloi se asnjë ligj nuk ishte shkelur, porse rrjetet duhej të pajtoheshin që të jenë më të kujdesshme në planifikimet e tyre të ardhshme.

Skandali edhe më shumë shërbeu për të rritur reputacionin e Wellesit, si një gjeni krijues, që ka mjeshtëri të rrallë prej rrëfyesi. Kjo do ta shtyjë më tej në Hollivud, ku do ta bëjë regjinë dhe do të luajë në filmin Qytetari Kejn [Citizen Kane] të vitit 1941 – shpeshherë i cituar si filmi më i mirë i të gjitha kohërave.

Siç zbulon një klip i Arkivit të BBC-së, kur më pas është pyetur për transmetimin, Wellesi e bëri një pretendim të madh për ndikimin e qëndrueshëm që shfaqja e tij kishte në formësimin e opinionit publik. Tregoi se disa vite më vonë, gjatë një shfaqjeje patriotike që po jepte në radio, u përhap lajmi se Japonia kishte nisur sulmin e befasishëm në bazën amerikane në Përl Harbor.

"Isha në mes të një himni lavdëruar për fushat e misrit amerikan ose diçka të tillë", tregonte ai, "kur befas një zotëri hyri në studion e radios, e ngriti dorën dhe tha: 'Po e ndërpresim këtë transmetim, për t'ju dhënë një njoftim: Përl Harbori sapo është sulmuar'. Dhe, sigurisht, ky lajm shumë i rëndë dhe i tmerrshëm, kurrë nuk u besua. Për orë të tëra, nga askush në Amerikë, sepse të gjithë thanë: 'Epo, e bëri përsëri; vërtet, një gjë kjo shumë e keqe; ishte qesharake një herë, por jo për të dytën herë'".

Në vitet që pasuan, ka pasur shumë debate nëse niveli i panikut që transmetimi vërtet shkaktoi, ka qenë i mbivlerësuar apo se sa njerëz në të vërtetë e dëgjuan transmetimin – në krahasim me leximin e raporteve të gazetave për të. Por, pavarësisht kësaj, mbetet një ngjarje e madhe në historinë e transmetimit dhe dëshmi për fuqinë që ka mënyra e rrëfimit në kaptimin e imagjinatës së audiencës. /Telegrafi/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Drejtuesit e KOK-ut pritën ekipin e karatesë pas suksesit historik në Budapest

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Drejtuesit e KOK-ut, presidenti Ismet Krasniqi dhe nënpresidentët Gazmend Maxhuni e Milaim Kelmendi, kanë pritur të mërkurën ekipin e karatesë pas suksesit historik të arritur në Kampionatin Botëror në Budapest, në të cilin ekipi i vajzave fitoi medaljen e bronzit në ekipore. Presidenti Krasniqi përgëzoi

ekipin e vajzave, duke thënë se suksesi i tyre na bënë krenarë të gjithëve dhe që vjen pas një pune dhe përkushtimi ndër vite të karateisteve dhe gjithë komunitetit të karatesë. Në emër të ekipit, sekretari i përgjithshëm i Federatës së Karatesë së Kosovës, Nazmi Gashi, falënderoi drejtuesit e KOK-ut për mbështetjen e vazhdueshme, duke thënë se

suksesi i arritur erdhi pas një konkurrence tejet të fortë, ku u përballën me shtete që kanë lënë gjurmë jo vetëm në Kampionate Botërore, por edhe në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". Për rrugëtimin deri te medalja dhe sfidat që kishin, folën edhe përzgjedhësi Isak Latifi, trajneri Alban Beqiri dhe karateistet Fortesa Orana, Vlera Qerimi e Hatixhe Zejnullahu.



## Ballkani tregon forcën edhe në derbin ndaj Dritës

Ballkani vazhdon të jetë skuadër e suksesshme në Superligë, pasi e ka mposhtur Dritën dhe ka shtuar dallimin me këtë klub në shtatë pikë. Të mërkurën fitore ka shënuar Malisheva ndaj Prishtinës, sikurse edhe Gjilani ndaj Feronikelit 74. Sot (e enjte) zhvillohen edhe dy ndeshjet e tjera të javës së 12-të ku do të takohen Llapi - Fushë-Kosova dhe Liria - Dukagjini

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

Skuadra kampione në fuqi e Kosovës në futboll, Ballkani, ka shënuar fitore në ndeshjen derbi ndaj rivalit kryesor për titull të kampionit, Dritës, me rezultat 1-0. "Gëzimi është evident kur luan gjithmonë karshi Dritës, që mban pozicionin e dytë në tabelë dhe ishte përballja jonë e parë, sepse kemi pasur një ndeshje të shtyrë. Lojtarët e dyja ekipeve u pa që nuk kishin energjinë e madhe në këmbët e tyre, por u vendos nga një gjuajtje e mirë e Dellovës, pastaj edhe zëvendësimet i dhanë besim grupit. Përveç marrjes së pikëve të plota, fitorja lehtëson

edhe anën psikologjike të lojtarëve, pasi mposhtëm rivalin direkt për titull të kampionit", ka thënë pas ndeshjes Ilir Daja, trajneri i Ballkanit. Pjesa e parë përfundoi me rezultat 1-0, derisa golin e vetëm e shënoi Lumbardh Dellova në minutën e 37. Në pjesën e dytë Ballkani realizoi edhe një gol me anë të Walid Hamidi, por i cili u anulua. Duhet cekur se klubi gjilanas ka pasur paraqitje të mirë dhe se ka krijuar shumë raste shënimi të cilat nuk ka arritur t'i konkretizojë në gol. "Jo, nuk e ndiej presionin pas kësaj humbje pasi ka shumë ndeshje deri në fund të kampionatit, edhe pse do të jetë shumë vështirë. Mendoj se ka



qenë një ndeshje e mirë, ku kemi dominuar Ballkanin gjatë 90 minutave, por pësua nga një goditje", ka deklaruar Akis Vavalis, trajneri i Dritës. Pas kësaj fitore, Ballkani vazhdon të jetë në krye me 29 pikë, derisa Drita mbetet në pozitën e dytë me 22 pikë. Të mërkurën janë zhvilluar edhe dy ndeshje të tjera. Vlen të ceket se Malisheva e ka mposhtur

Prishtinën me rezultat 1-0. Kryeqytetasit pas ndryshimeve në shtabin teknik arritën fitore në fundjavë, por që tash përsëri u rikthehen rezultateve negative. Golin e vetëm në këtë ndeshje e realizoi katër minuta pa përfunduar koha e rregullt, Ilir Mustafa. Pas kësaj ndeshje, Malisheva barazohet me pikë me skuadrën e Prishtinës (16 sosh).

SUPERLIGA	
Gjilani - Feronikeli '74	2-1
Malisheva - Prishtina	1-0
Ballkani - Drita	1-0
Të enjten takohen:	
Llapi - Fushë-Kosova	
Liria - Dukagjini	

Edhe në ndeshjen tjetër fituese ishin vendasit, pra Gjilani e mposhti skuadrën e Feronikelit 74 me rezultat 2-1. Ismajli e Milev realizuan për vendasit, kurse për mysafirët shënoi Shillova. Pas kësaj fitore, Gjilani ka 14 pikë, derisa "Nikli" mbetet në kuotën e 11 pikëve. Në kuadër të kësaj xhiro sot (e enjte) do të zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera. Llapi e pret në stadiumin "Zahir Pajaziti" skuadrën e Fushë-Kosovës, nga i cili takim pret tri pikë në mënyrë që të mos lejohet shpëputjen e Ballkanit edhe më shumë. Në ndeshjen tjetër që zhvillohet në Prizren, Liria e pret skuadrën e Dukagjinit të Klinës.

## Sorschag: Mezi po pres të fluturoj për Kosovën në të gjithë botën



PRISHTINË, 1 NËNTOR - Sophie Sorschag është e gatshme ta përfaqësojë Kosovën në Kupën e Botës, e cila do të mbahet prej 1 deri më 3 dhjetor të këtij viti në Lillehammer të Norvegjisë. Skitarja e njohur austriake vendosi t'i bashkohej Kosovës, të cilën do ta përfaqësojë në garat me ski në ngjarjet e rëndësishme. Kampionia e botës në garat ekipore me

Austrinë në vitin 2021, e cila mori pjesë në Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekin 2022", do të përpiqet ta përfaqësojë denjësisht vendin tonë. "Mezi po pres të fluturoj për Kosovën në të gjithë botën", ka thënë Sophie Sorschag për faqen zyrtare të Komitetit Olimpik të Kosovës. Karriera dhe potenciali i saj japin shpresa për medalje historike për

Kosovën në sportet dimërore, pse jo edhe në këtë Botëror, por edhe në Lojërat Olimpikë Dimërore "Milano Kortina 2026". Sorschag, e cila kishte vendosur qysh në janar të këtij viti për ta lënë Austrinë dhe për të garuar për Kosovën në garat ndërkombëtare, është dashur të presë rreth 10 muaj për t'iu dhënë drita e gjelbër nga Federata Ndërkombëtare e Skive (FIS).

## Gjimshiti në formacionin e muajit në Serinë A

Bergamo, 1 nëntor - Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Berat Gjimshiti, sikurse në kombëtaren kuqezi, po vazhdon shkëlqimin edhe në futbollin italian. Mbrojtësi nga

Lugina e Preshevës është një krenari për të gjithë, teksa është nga më të mirët në rolin e tij në Serinë A. Muaji tetor është mbyllur me statistika shumë pozitive për Berat Gjimshitin.

Kapiteni shqiptar është përzgjedhur si një nga futbollistët më të mirë të muajit tetor në Serinë A. "Who Scored" e ka vlerësuar me notën 7.3 ecurinë e tij përgjatë

këtij muaji. Formacioni: M. Di Gregorio, Kayode, Acerbi, Gjimshiti, F. Parisi, Soule, Ferguson, Çalhanoglu, Kvarnshelia, Thuram, Castellanos.



## Alonso: Tashmë nuk kemi asnjë objektiv, sezoni u përmbys në mënyrë të çuditshme

OVIEDO, 1 NËNTOR - Pas një sezoni që nisi në mënyrë të shkëlqyer për skuadrën Aston Martin, me disa podiume në garat e para të Formulës 1 me pilotin Fernando Alonso, situata u përmbys në gjysmën e dytë të sezonit. Një makinë që tashmë është në krizë,

çka e konfirmoi gara e fundit në Meksikë, ku të dy pilotët u tërhoqën nga gara. Aston Martin kaloi nga forca e dytë në atë të pestë, duke u parakaluar edhe nga McLareni. "Ndershmërisht, me këtë makinë që kemi nuk mund të duelojmë më për asnjë objektiv

tjetër në tri garat e mbetura. Në botërorin për konstruktorë jemi bllokuar në vendin e pestë, ndërsa në atë për pilotë do të humbasim disa pozicione", ka thënë Alonso. "Është e çuditshme që edhe pse mund të kualifikohemi para Ferrarit arrijmë të humbasim

pozicione në garë, pasi ai ka një makinë më të shpejtë. Të shohim se çfarë mund të bëjmë në garat e mbetura, duke punuar sa më shumë të jetë e mundur. Nuk jemi të kënaqur me këtë situatë", ka deklaruar dy herë kampioni i botës në Formula 1.



## 15 ndeshje në muajin nëntor për kombëtaret e Shqipërisë



TI Ranë, 1 NËNTOR - Thuajse të gjithë ekipet kombëtare kuqezi do të jenë të angazhuara në 15 ndeshje në muajin nëntor. Sfidat zyrtare dhe miqësore janë në program për kuqezinjtë, duke nisur nga Kombëtarja e Futsallit, për të vijuar te moshat e më pas te Kombëtarja A dhe Shqipëria U-17 e vajzave. Kombëtarja shqiptare e Futsallit do të zbresë e para në fushë. Me 8 dhe 9 nëntor do të zhvillojë dy sfida miqësore kundër Malit të Zi, në sallën e lojërave me dorë "Feti Borova" në kryeqytet, njofton Federata Shqiptare e Futbollit. Për Kombëtaret U19 dhe U17 janë në program në total gjashtë ndeshje kualifikuese për Evropianin e këtyre grupmoshave. Shqipëria U19 do t'i luajë sfidat kualifikuese në Grupin 13, në datat 15, 18 dhe 21 nëntor kundër Irlandës, Belgjikës dhe Sllovenisë. Të gjitha ndeshjet kualifikuese të këtij grupi do të luhen në vendin tonë, nën mbikëqyrjen dhe organizimin e FSHF-së. Në datat 15, 18 dhe 21 nëntor do të luajë edhe Shqipëria U17 sfidat kualifikuese të Euro

23/24 për këtë grup-moshë. Kuqezinjtë janë pjesë e grupit 5 dhe do të udhëtojnë drejt Portugalisë, aty ku do të zhvillohen ndeshjet kualifikuese. Shqipëria U17 e drejtuar nga Ardi Behari do ta luajë ndeshjen e parë ndaj vendasve të Portugalisë dhe më pas do të ndeshen ndaj Çekisë dhe Malit të Zi. Fokusi kryesor është te Kombëtarja A. Shqipëria e drejtuar nga trajneri Sylvinho do ta zhvillojë sfidën e parafundit kualifikuese në Grupin E, me datë 17 nëntor në transfertë ndaj Moldavisë. Kuqezinjtë u mjafton vetëm një pikë për ta siguruar matematikisht kualifikimin në "Gjermani 2024". Tri ditë më vonë, me datë 20 nëntor, Shqipëria do të luajë ndeshjen e fundit në Grupin E ndaj Ishujve Faroe në "Air Albania", në orën 20:45. Shqipëria U21 do të zhvillojë dy ndeshjet e radhës për kualifikueset e "Euro 2025", të dyja në transfertë, fillimisht me Rumaninë më 17 nëntor, ndërsa më 21 nëntor do të luajnë ndaj Malit të Zi. Shqipëria U21 udhëheq Grupin E me nëntë pikë pas katër ndeshjeve të

### KOMBËTARJA A - KUALIFIKUESET E "EURO 2024"

Moldavi-Shqipëri 17.11.2023, ora 18:00  
Shqipëri-Ishujt Faroe 20.11.2023, ora 20:45

### KOMBËTARJA U21 - KUALIFIKUESET E "EURO 2025"

Rumani-Shqipëri 17.11.2023, ora 19:30  
Mal i Zi-Shqipëri 21.11.2023, ora 15:00

### KOMBËTARJA U19 - KUALIFIKUESET E EVROPIANIT

Irlande-Shqipëri 15.11.2023, ora 14:00  
Belgjike-Shqipëri 18.11.2023, ora 14:00  
Shqipëri-Sloveni 21.11.2023, ora 14:00

### KOMBËTARJA U17 - KUALIFIKUESET E EVROPIANIT

Portugali-Shqipëri 15.11.2023, ora 18:00  
Çeki-Shqipëri 18.11.2023, ora 14:00  
Shqipëri-Mal i Zi 21.11.2023, ora 17:00

### KOMBËTARJA E FUTSALLIT - MIQËSORE

Shqipëri-Mal i Zi 08.11.2023, ora 19:00  
Shqipëri-Mal i Zi 09.11.2023, ora 17:00

### KOMBËTARJA U17 E VAJZAVE - RAUNDI I PARË I KUALIFIKUESEVE TË "EURO 2024"

Uells-Shqipëri 24.11.2023, ora 14:00, Shtëpia e Futbollit  
Ishujt Faroe-Shqipëri 27.11.2023, ora 14:00, Shtëpia e Futbollit  
Shqipëri-Kazakistan 30.11.2023, ora 14:00, Shtëpia e Futbollit

zhvilluara. Kombëtarja U17 e vajzave do të luajë me 24, 27 dhe 30 nëntor raundin e parë kualifikues të Euro 2024. Të tri sfidat do të zhvillohen në "Shtëpinë e Futbollit" fillimisht ndaj Uellsit, më pas ndaj Ishujve Faroe dhe Kazakistanit.

## San Antonio fiton në sekondat e fundit ndaj Phoenixit

SAN ANTONIO, 1 NËNTOR - Janë luajtur vetëm tri ndeshje së fundmi në NBA, por nuk ka munguar spektakli dhe emocionet. Në Konferencën e Perëndimit ekipi i San Antonios fitoi në sekondat e fundit 115-114 ndaj Phoenixit, në një ndeshje mjaft emocionuese. Vendasit e Phoenixit bënë një pjesë të parë shumë të mirë, duke shkuar deri në 18 pikë avantazh, ndërsa miqtë në pjesën e dytë jo vetëm që rikuperuan, por në fund arritën ta përmbysnin rezultatin, duke triumfuar me një pikë më shumë. Keldon Johnson



me 27 pikë bëri diferencën për Spursin në këtë sukses, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e Kevin Durantit për Suns. Po në këtë konferencë nuk zhgënjën Los Angeles Clippers, që falë 27 pikëve të veteranit Paul George, mundi

118-102 Orlando Magicun. Një ndeshje e ekuilibruar në përgjithësi, por vendasit kalifornianë e bënë dallimin në periodën e tretë, ndërsa në të katërtën thjesht menaxhuan avantazhin. Për miqtë mungoi lojtari lider, në një ndeshje ku Banhero realizoi 15 pikë. Ndërsa në Lindje, jashtë fushës fitoi skuadra e New York, që mundi 109-91 Cleveland, në një sfidë të dominuar nga miqtë. Bronson e Rundle, me nga 19 pikë secili, u dalluan për Knicksin, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e Donovan Mitchellit.

### SHKURT

#### Grosso flet për herë të parë pas incidentit: Mund të ishte tragjedi

Trajneri i Lyonit, Fabbio Grosso, kaloi një fundjavë të vështirë, teksa u godit me gurë në fytyrë nga tifozët e Marseilles pranë stadiumit "Velodrome". Për këtë episod ka folur për herë të parë vetë trajneri italian. "Ajo që ndodhi të dielën mund të ishte një tragjedi dhe me siguri kështu është për sportin dhe për të gjithë ata që e duan këtë lojë. Uroj me gjithë zemër që të ketë qenë një lëksion për të ardhmen tonë. I falënderoj të gjithë për mbështetjen dhe që më keni qëndruar pranë", ka thënë Grosso.

#### Unitedi e dëshiron Griezmannin

Manchester Unitedi është duke shqyrtuar mundësinë për transferimin e yllit të Atletico Madridit, Antoine Griezmann. Mediumi spanjoll "Ok Diario" raporton se "Djajtë e Kuq" e pëlqejnë tejet shumë francezin, andaj po shpresojnë në një marrëveshje qysh në janarin që po vjen. Gjithnjë në bazë të raportit, ekziston një klauzolë lirim në vlerën e 25 milionë euro që mund të bëhet aktive nga skuadra angleze nëse pajtohen me lojtarin. Mirëpo, Unitedi fillimisht duhet ta bindë Griezmannin, i cili është shumë i lumtur tek Atletico, madje francezi verën që lamë prapa kishte refuzuar një ofertë të "çmendur" financiare nga një klub arab.

#### Klubet arabe në garë për De Bruyne, City kërkon 60 milionë euro

Kevin De Bruyne mund të largohet nga Manchester City pas tetë viteve qëndrim në "Etihad Stadium". 32-vjeçari ka kontratë me Cityn deri në verën e vitit 2025, por ai mund të largohet nga kampionët në fuqi të Anglisë qysh në afatin kalimtar dimëror. Skuadra arabe Al Nassr ka shprehur interesim të madh për të, derisa "Football Insider" ka raportuar se City i ka caktuar edhe çmimin e largimit. Te City janë pajtuar me largimin e De Bruynes shkaku i gjendjes së tij fizike dhe do ta lënë të lirë në janar nëse vjen një ofertë prej 60 milionë eurove. Jo vetëm Al Nassr, por interesim për të kanë shprehur edhe skuadra të tjera si Al-Hilal dhe Al-Ettifaq.

#### Balotelli: Interi është favorit për 'Scudetto'

Sulmuesi i Adane Demirspor, Mario Balotelli, ka folur në lidhje me garën për titullin në Serinë A. "Mes Juves, Napolit e Milanit është një sfidë e bukur për të arritur i dyti. Për mua këto skuadra nuk e arrijnë dot Interin", ka deklaruar Balotelli. "Nëse do ta kapnin e parakalonin skuadrën e Inzaghit do të ishte bukur, por për momentin skuadra e Interit më duket më superiore se të tjerat. Gjithsesi, të flasësh për titullin kampion që në nëntor është paksa e ndërlikuar", u shpreh Balotelli. Ai ka folur edhe për Marcus Thuram, sulmuesin e ri të Interit, që vendosi ndeshjen e fundit ndaj Romës, lojtarin që zuri vendin e Lukakut. "Nuk është e vërtetë që sulmi i Juventusit është më i mirë se ai i Interit. Kam luajtur me Thuram kur ishte më i ri dhe nuk ishte kaq i fortë sa është sot. Është përmirësuar ndjeshëm. Nëse do të bëja një krahasim mes Lukakut dhe Thuramit do t'i zgjidhja këtë të fundit për sa i përket talentit dhe aftësisë në fushë", ka shtuar Balotelli.

## Haalandi komenton triumfin e Messit në garë për 'Topin e Artë'

Nëse nuk do të ishte ai Botërori i fituar nga Lionel Messi me Argentinën, Erling Haaland do të kishte qenë i pari. 56 gola në 56 ndeshje dhe fitorja e tripletës me

Manchester Cityn do ta kishin bërë fare mirë një fitues të denjë të "Topit të Artë". Haalandi është shprehur se nuk ka asnjë peng që këtë vit çmimin ta fitonte edhe

njëherë Lionel Messi: "Nuk është logjike që të mos ia japësh trofeun e lojtarit më të mirë në histori, aq më tepër që ka fituar edhe kampionatin Botëror. Ne

bëmë një sezon fantastik, fituam tre trofe dhe mendoj se nuk mund të kishim bërë më mirë. Por këtë sezon do të provojmë të fitojmë sërish gjithçka. Kemi një

skuadër fantastike. Falënderoj klubin dhe familjen. Të shënoj gola është profesioni im, puna ime. Luaj në një klub me lojtarë dhe staf teknik të mëdhenj".



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

### THIRRJE PUBLIKE

#### TRAJNER PËR MBAJTJEN E TRAJNIMIT NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE NË KOMUNËN E PRISHTINËS

##### Hyrje

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtrojnë veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

##### Përshkrim i shkurtër i qëllimit të projektit

Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit në mes të Komunës së Prishtinës dhe Odës së Mjekëve të Kosovës, Tetor 2022, për t'i mundësuar stafit të institucioneve shëndetësore në komunën e Prishtinës, të ofrojë shërbime cilësore për pacientët, bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira mjekësore, Oda e Mjekëve të Kosovës bën thirrje për Trajnerët të cilët do të ofrojnë trajnime në ultrasonografi si ndihmesë në diagnostifikim klinik si dhe diagnostifikimin diferencial klinik.

##### Objektivat e angazhimit dhe rezultatet e pritura

Objektivi i këtij angazhimi të trajnerëve është të sigurojë një program trajnime për personelin mjekësor në institucionet shëndetësore në komunën e Prishtinës në fushat si në vijim:

- Ultrasonografia e abdomenit dhe pelvikut

Trajnimet priten t'u ofrojnë mjekëve aftësi në përdorimin e ultrasonografisë në funksion të diagnostifikim klinik si dhe diagnostifikimin diferencial klinik.

Trajnimet duhet të rrisin shkathtësitë e stafit të përzgjedhur për të punuar në departamente të ndryshme të sektorit parësorë, si dhe do të mundësojnë për të mësuar më shumë rreth cilësisë dhe sigurisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

##### Metodologjia

Trajnerët e përzgjedhur do të punojnë ngushtë me stafin e departamenteve relevante Institucioneve shëndetësore të Komunës së Prishtinës dhe do të ofrojnë trajnime në formë të:

- Trajnimeve në punë
- Seminareve/Punëtorive
- Trajnimeve virtuale
- Trajnimeve hibride (virtuale dhe fizike)

##### Pritshmëritë

Nën udhëzimin e përgjithshëm të OMK-së dhe të Departamentit për Shëndetësi të Komunës së Prishtinës dhe në bashkëpunim me ekipin trajneri i angazhuar pritet të:

- Përgatit module të trajnimit
- Propozojë afatin kohor të sesioneve të trajnimit
- Vlerësojë proceset dhe protokollet ekzistuese në departamentet përkatëse brenda institucioneve shëndetësore në komunën e Prishtinës
- Mbështet stafin për të përpunuar protokollet dhe udhëzimet e nevojshme
- Së bashku me trajnuesit, të përpilojë Procedura Standarde të Operimit
- Përgatit një raport përfundimtar mbi zbatimin e aktiviteteve

Trajneri do të punojë drejtpërdrejt me mjekët e departamenteve përkatëse të institucioneve të mjekësisë familjare të Komunës së Prishtinës. Megjithatë, për të kryer me sukses detyrat e mësipërme, ai/ajo do të punojë ngushtë me ekipet e menaxhimit të institucioneve shëndetësore dhe do të sigurojë raporte mujore që përmbledhin progresin dhe arritjet. Eksperti është i detyruar të përgatisë raporte javore të progresit, të cilat do t'u dërgohen për miratim menaxhimit të institucioneve shëndetësore dhe Kryetarit të Odës së Mjekëve të Kosovës.

##### Kohëzgjatja

Fillimi: Nëntor 2023

Koha e parashikuar e punës: 30 ditë brenda 3 muajve

Hapil #	Përshkrimi i aktivitetit	Nr. ditëve	Vendi
1	Përgatit dhe prezanton përmbajtjen e moduleve të trajnimit	2	Vend i pacaktuar
2	Organizon dhe zbaton sesione trajnime - në punë dhe sesione trajnime on-line	20	Në një vend të caktuar
3	Kryen një vlerësim për të rishikuar proceset dhe protokollet ekzistuese në departamentin përkatës	4	Vend i pacaktuar
4	Harton udhëzime dhe protokolle për përdorim	4	Vend i pacaktuar
<b>Total</b>		30	

##### Kualifikimet dhe përvoja

- Diplomë universitare në Mjekësi;
- Specializimi;
- Niveli akademik paraqet përparsi;
- Leje pune dhe licencë nga institucionet përkatëse profesionale;
- Minimumi 10 vjet përvojë në departamentet përkatëse të specializuara;
- Certifikata nga trajnimet e vijuar në fushën përkatëse;
- Aftësi të forta ndërpersonale;
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit verbal pedagogjik dhe në të shkruar dhe përvojë e demonstruar në punën me ekupe të ndryshme;
- Njohës i TI-së,dhe
- Njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe angleze në të shkruar dhe në të folur paraqet përparsi.

##### Dokumentet dhe procedura për aplikim:

- Kopja e diplomave
- Kopja e Certifikatës së Licencimit nga institucioni përgjegjës;
- Kopja e certifikatave
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Një draft propozim mbi metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë planifikimin e procesit të zhvillimit të trajnimit përkatës dhe mbajtjen e trajnimeve;
- Një letër që përfshinë ekspertizën dhe përvojën në fushën e mbajtjes së trajnimeve në njërin nga fushat e kontratës;
- Curriculum Vitae (CV), dhe
- Propozim financiar

Propozimi financiar\* \*Kërkesa financiare duhet të jetë e detajuar për secilën punë që do të realizohet, këtu duhet të përfshihet, mbajtja e trajnimeve, shkrimi i raporteve dhe një plan tentativë i punës;

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: info@omk-rks.org me subjektin Aplikacioni për Trajner/e për mbajtjen e trajnimit nga lëmia e ultratingullit në institucionet shëndetësore në komunën e Prishtinës apo edhe në mënyrë fizike në zyrat e Odës së Mjekëve të Kosovës, adresa QKUK, Instituti A, Kati III, 10000, Prishtinë.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është me datë: 15 Nëntor 2023, ora 16:00. Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Toni Compani” Sh.p.k, Z.K Tankosiq, K. Ferizaj në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Bazën e Betonit në Z.K Tankosiq, K. Ferizaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.12.2023 në ora 11:00 në SHFMU "Dituria" Dardani (Tankosiq) Ferizaj, do të organizohet debat publik nga Kompania “Toni Compani” Sh.p.k, Z.K Tankosiq, K. Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM.

<https://us05web.zoom.us/j/2290262270?pwd=wh1a3KMLfTOxYqOuerxDSxSKBCJ7Ss.1#success>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Toni Compani” Sh.p.k, Z.K Tankosiq, K. Ferizaj, për Bazën e Betonit në Z.K Tankosiq, K. Ferizaj.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnk.komente@rks-gov.net](mailto:vnk.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “GLK Motors” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810601329 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “GLK Motors” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810601329 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “GLK Motors” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810601329 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Arti A 06 Group” SH.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811945130 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Arti A 06 Group” D.O.O. od Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811945130 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Arti A 06 Group” L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811945130 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Blenard Spahija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “Hajdar Dushi”.

- Emrllah Zeqiri nga Gjilani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike.

- HLB Audit Kosova L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik: 82027896.

- Liridon Ahmetaj shpall te pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Bajram Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl I, II SHFMU “Leke Dukagjini” Prizren.

- Murat Duraj shpall te pavlefshme dëftesat e kl X, XI, XII, XIII dhe diplomën SHME “Ymer Prizreni” Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

